

VENDIM
Nr. 282, datë 21.5.2025

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 41, DATË 24.1.2018, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR ELEMENTET E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË
OFRUARA NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 71, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, në tabelën 1, të shtojcës nr. 1, për komponentin mësimor, kategoria “E”, “Detyrime përmbyllëse”, kolona “Master i shkencave/“Master i arteve”, bëhet “10–25 % kredite”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku